



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE
DREJTORIA EKONOMIKE

MANUALI I MENAXHIMIT

TË PROVIZIONEVE

PUNOI

Suzana ÇULI

Njësia e Menaxhimit të Riskut

MIRATOI

Redina KODRA

Drejtor i Përgjithshëm

BASHKËPUNOI

Marko DHANA

Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
1.1. Baza ligjore dhe rregullatore	4
1.2. Qëllimi i Manualit	4
1.3. Objektivat	5
1.4. Përkufizimet kryesore	5
2. NJOHJA E PROVIZIONEVE - RREGULLA TË PËRGJITHSHME	6
2.1. Njohja e provizioneve	7
2.2. Matja e provizioneve	8
2.3. Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve	9
2.4. Përdorimi i provizioneve	9
2.5. Provizionet për zhvlerësimin e inventareve	14
2.6. Provizionet për klientë të dyshimtë	16
3. NJOHJA E PROVIZIONEVE - FUSHAT SPECIFIKE	20
3.1. Provizionet e garancisë	20
3.1.1. Kontabiliteti i provizioneve për risqe e shpenzime	21
3.1.2. Zvogëlimi ose anulimi i një provizioni	22
3.2. Provizionet që lidhen me çështjet gjyqësore	24

3.3. Provizionet që lidhen me kontrata me kushte rënduese	25
3.4. Provizionet për detyrimet mjedisore	25
3.5. Provizionet për kostot e ristrukturimit	26
 4. DETYRIMET E KUSHTËZUARA	 28
 5. AKTIVET E KUSHTËZUARA	 29
 6. PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS	 29

1. HYRJJE

Ky dokument përcakton mënyrat që duhen përdorur në Entin Kombëtar të Banesave për të menaxhuar provizionet gjatë kryerjes së aktivitetit të tij. Njohja dhe vlerësimi i provizioneve zë një vend të rëndësishëm për kryerjen e misionit të insitucionit.

Provizionet janë një element tepër i rëndësishëm për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe sistemin e aftësisë paguese, prandaj ato duhet të llogariten në mënyrë të besueshme, objektive dhe konsistente.

Në këtë manual jepen informacione të rëndësishme për njohjen, matjen, dhe përdorimin e provizioneve, si dhe shpjegohen metodat dhe procedurat për vlerësimin e provizioneve, duke dhënë detaje për mënyrat specifike të trajtimit të tyre. Në mënyrë të veçantë shpjegohen proceset që duhet të ndiqen nga Drejtoria Ekonomike në Drejtorinë e Përgjithshme, si dhe nga Specialistët e Financës në Degët Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave, gjatë punës së tyre për llogaritjen dhe menaxhimin e provizioneve.

1.1. Baza ligjore dhe rregullatore

Kontabiliteti i provizioneve organizohet në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin”, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit. Baza ligjore që ka shërbyer për përgatitjen e manualit, është paraqitur si më poshtë:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Standarti Kombëtar i Kontabiliteti nr. 6 “Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara”, i ndryshuar.

Enti Kombëtar i Banesave përcakton me rregulla të brendshme politikat dhe procedurat kontabile të miratuara nga Këshilli Drejtues.

1.2. Qëllimi i Manualit

Ky dokument ka për synim të theksojë rëndësinë e menaxhimit të provizioneve në Entin Kombëtar të Banesave, të mbështesë stafin dhe të sigurojë krijimin e proceseve të duhura për të vlerësuar dhe përdorur provizionet.

Qëllimi i këtij manuali është të përshkruajë njohjen, matjen, krijimin, vlerësimin dhe përdorimin e provizioneve, gjatë aktivitetit që kryen Enti Kombëtar i Banesave gjatë veprimtarisë së tij, si dhe klasifikon provizionet dhe mënyrat e vlerësimit të tyre.

Procedurat e ndjekura sigurojnë një proces të vazhdueshëm të vlerësimit të provizioneve për të kryer shpërndarjen dhe nivelin e ndikimit në performancën e aktivitetit të Entit Kombëtar të Banesave. Qëllimi i marzhit të aftësisë paguese është të sigurojë një nivel sigurie kundrejt ngjarjeve që mund të ndodhin, të cilat janë jashtë parashikimeve, megjithë masat për parandalimin e tyre.

Ky manual ndihmon të bëhet dallim mes situatave, ku njohja e një provizioni është e nevojshme të bëhet në bilanc, dhe situatave kur është e mjaftueshme që të shpjegohet pasivi i kushtëzuar, vetëm në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Një sistem mbikëqyrës i shëndoshë duhet të kombinojë mjaftueshmërinë e kapitalit dhe sistemin e aftësisë paguese me kërkesat për sisteme për menaxhimin e provizioneve dhe kontrollin e tyre.

1.3. Objektivat

Objekti i këtij manuali është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të provizioneve, aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto standarte bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranura në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Enti Kombëtar i Banesave mundohet të aplikojë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës, ndryshimeve në pozicionin financiar dhe fluksit të parasë.

Për hartimin e këtij manuali jemi mbështetur tek **Standarti Kombëtar i Kontabiliteti nr. 6 “Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara”, i ndryshuar**, i cili përdoret për:

- (a) krijimin, llogaritjen, njohjen dhe vlerësimin e provizioneve në pasqyrat financiare;
- (b) shpjegimet e pasiveve dhe aktiveve, të kushtëzuara në pasqyrat financiare.

Gjatë kryerjes së punës Enti Kombëtar i Banesave do të haset me situata kur njohja e një provizioni është e nevojshme të bëhet në pasqyrën e pozicionit financiar, dhe situata të tjera kur është e mjaftueshme që të shpjegohet detyrimi i kushtëzuar, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

1.4. Përkufizimet kryesore

Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore të përdorura në këtë manual:

Provizioni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Termi “provizion” përdoret shpesh në kontekstin e zërave të tillë si amortizimi, zhvlerësimi i aktiveve, dhe llogari të arkëtueshme të pambledhshme. Këto kanë të bëjnë me rregullimet e vlerave kontabël të aktiveve, dhe jo me njohjen e detyrimeve.

Pasivi është një detyrim që:

- (a) ka lindur nga ngjarje të shkuara;
- (b) shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me një dalje të burimeve.

Ngjarja detyruese është ngjarje që krijon një detyrim ligjor ose ekonomik.

Detyrimi ligjor është detyrim që rrjedh nga:

- (a) një kontratë, nëpërmjet kushteve të shprehura ose të nënkuptuara të kontratës;
- (b) legjislacioni apo një akt tjetër ligjor.

Detyrimi konstruktiv është detyrim që rrjedh nga veprimet e Entit Kombëtar të Banesave ku:

- (a) në bazë të një modeli të vendosur nga praktikrat e shkuara, politika të shpallura ose një deklarami specifik, institucioni ua ka bërë të ditur palëve të tjera se do të pranojë përgjegjësi të caktuara;
- (b) si rezultat, Enti Kombëtar i Banesave ka krijuar një pritshmëri të arsyeshme të palët e tjera, se ai do t'i shlyejë këto përgjegjësi.

Detyrimi i kushtëzuar është:

- (a) një detyrim që krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të Entit Kombëtar të Banesave;
- (b) një detyrim ekzistues që rrjedh nga ngjarje të shkuara, por që nuk është njohur pasi:
 - (1) ka mundësi që shlyerja e detyrimit nuk do të shoqërohet me dalje të burimeve ekonomike,
 - (2) shumat ose vlerat e detyrimit nuk mund të vlerësohet me saktësi të mjaftueshme.

Aktiv i kushtëzuar është një kërkesë e krijuar nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e së cilës do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, që nuk janë nën kontrollin e plotë të Entit Kombëtar të Banesave.

2. NJOHJA E PROVIZIONEVE - RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Provizionet mund të dallohen nga pasive të tjera “të zakonshme” pasi në to ka pasiguri mbi kohën ose shumën e shpenzimeve të ardhshme për t'u shlyer. Shuma e përdorur për njohjen e detyrimeve “të zakonshme” përcaktohet në përgjithësi nëpërmjet një fature, kontrate ose dokumenti tjetër, dhe nuk ka nevojë për një vlerësim kontabël.

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Enti Kombëtar i Banesave ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mirat ekonomike do të kërkojnë për shlyerjen e këtij detyrimi. Nëse efekti është material, provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, riskun specifik të detyrimit.

Metodologjitë dhe praktikrat e kontabilitetit të përdorura në përcaktimin e provizioneve dhe trajtimin e aktiveve, veçanërisht aktiveve në mbulim të provizioneve, duhet të merren në konsideratë gjatë kërkesave për aftësi paguese që rrjedhin nga provizionet.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe sistemi i aftësisë paguese duhet të marrin në konsideratë vlerësimin e detyrimeve përfshirë dhe provizionet. Provizionet duhet të vlerësohen në mënyrë transparente, pra duhet të jenë të vlerësuara saktë me qëllim mbulimin e detyrimeve.

Për njohjen e provizioneve në pasqyrën e pozicionit financiar, për përcaktimin e shumës së nevojshme për shlyerjen e provizioneve ose afatit kohor të provizioneve, do të merret për bazë opinioni i drejtuesve ose ekspertëve. Meqenëse vlerësimi i provizioneve bazohet në vlerësime që mund të mos jenë gjithmonë të sakta, është e rëndësishme që ato të njihen dhe raportohen të ndara nga detyrimet e tjera.

Pasiguria, përsa u përket detyrimeve të kushtëzuara, është edhe më e madhe sesa pasiguria në lidhje me provizionet. Nëse realizimi i provizioneve është relativisht i sigurt dhe shuma mund të vlerësohet në mënyrë relativisht të saktë, kur flasim për detyrimet e kushtëzuara, ose realizimi i tyre është i sigurt, ose shuma nuk mund të vlerësohet me saktësi as edhe relativisht.

Shuma e njohur për provizion duhet të jetë përlllogaritja më e mirë e shpenzimeve që duhet të kryhen për të shlyer detyrimin aktual në datën e bilancit. Në rastet kur efekti i vlerës në kohë të parase është material, shuma e provizionit duhet të jetë vlera aktuale e shpenzimeve që priten të kërkojnë për të shlyer detyrimin. Rritja e mëpasshme e vlerës së provizionit duhet të regjistrohet si shpenzim financiar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.1. Njohja e provizioneve

Enti Kombëtar i Banesave do të njohë një provizion në bilanc në rastet kur:

- a-** institucioni ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv në datën e raportimit, si rezultat i një ngjarje të kaluar apo ngjarjeve që kanë ndodhur para datës së bilancit,
- b-** ekziston mundësia (d.m.th. ka më shumë gjasa se jo) që për shlyerjen e detyrimit do të nevojitet një dalje e burimeve,
- c-** shuma e detyrimit mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Enti Kombëtar i Banesave do ta njohë një provizion vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për Entin Kombëtar të Banesave, dhe që insitucioni nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.

Një provizion do të njihet, vetëm nëse mundësia për realizimin e tij është më e madhe se mosrealizimi i tij, d.m.th. ka më shumë gjasa se jo. Nëse mundësia e realizimit është më e vogël se mosrealizimi i tij, provizioni nuk do të njihet, por detyrimi do të paraqitet si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Në përgjithësi është gjithmonë e mundur të bëhet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së një provizioni të nevojshëm, d.m.th. shuma që nevojitet për shlyerjen e detyrimit. Në raste të rralla, kur nuk mund të bëhet një vlerësim i tillë, provizioni nuk do të njihet në pasqyrën e pozicionit financiar, por faktorët që lidhen me të do të përshkruhen si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Krijimi i një provizioni të ri, ose rritja e një provizioni ekzistues, zakonisht regjistrohet si një shpenzim i periudhës kontabël. Në rastin kur krijimi i një provizioni lidhet me përdorimin ose

shitjen, apo nxjerrjen jashtë përdorimit të një aktivi, shuma e një provizionit të tillë do t'i shtohet koston e këtij aktivi. Në çdo datë të mbylljes së bilancit, Drejtoria Ekonomike e Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe Specialistët e Financës në Degët Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave do të vlerësojnë nevojën për krijimin e provizioneve aktuale.

2.2. Matja e provizioneve

Shuma e njohur si provizion do të jetë vlerësimi më i saktë i mundshëm i shpenzimeve të nevojshme për shlyerjen e një detyrimi ekzistues të mundshëm, e vlerësuar kjo në datën e raportimit, pra do të jetë çmuarja më e mirë e pagesave të nevojshme për shlyerjen e një detyrimi aktual në datën e mbylljes së bilancit.

Shuma e nevojitur për shlyerjen e një detyrimi që lidhet me provizionin, shpesh varet nga një sërë faktorësh të jashtëm të cilët nuk janë nën kontrollin e Entit Kombëtar të Banesave, por mundësia e ndodhjes së tyre mund të çmohet. Në matjen e provizioneve, duhen marrë në konsideratë ngjarje të ndryshme të mundshme.

Shembull

Është hapur një çështje gjyqësore për Degën Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave dhe kjo procedurë është në vazhdim në datën e mbylljes së bilancit. Juristët e institucionit çmojnë se shpenzimet që lidhen me çështjen mund të jenë mes 200,000 dhe 400,000 Lekë, me probabilitet të njëjtë ndodhjeje. Dega Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave në këtë rast njeh një provizion në shumën 200,000 Lekë.

Duhet mbajtur mirë parasysh që:

- Një provizion do të përdoret vetëm për shpenzimet për të cilat provizioni është njohur fillimisht.
- Shpenzime të tjera nuk duhet të kompesohen kundrejt provizionit, pasi ato do të dëmtonin karakterin objektiv të pasqyrave financiare të Entit Kombëtar të Banesave.

a) Kur provizioni ka të bëjë me disa detyrime, vlerësimi i shumës së provizionit pasqyron peshën e të gjitha rezultateve të mundshme me probabilitetet e tyre përkatëse. Pra, provizioni do të jetë i ndryshëm në varësi të faktit nëse probabiliteti i humbjes për një shumë të caktuar është, për shembull, 60 për qind ose 90 për qind. Kur ka një varg rezultatesh të mundshme, dhe çdo pikë në këtë varg është po aq e mundshme sa çdo pikë tjetër, atëherë përdoret pika e mesit të vargut të vlerave.

b) Kur provizioni ka të bëjë me një detyrim të vetëm, rezultati më i mundshëm mund të jetë vlerësimi më i mirë i shumës së nevojshme për të shlyer detyrimin. Megjithatë, edhe në një rast të tillë, E.K.B. merr parasysh edhe rezultate të tjera të mundshme. Kur rezultatet e tjera të mundshme janë kryesisht më të larta ose kryesisht më të ulëta se sa rezultati më i mundshëm, atëherë vlerësimi më i mirë do të jetë respektivisht një shumë më e lartë ose më e ulët se rezultati i mundshëm.

c) Kur efekti i vlerës në kohë të parësë është material, shuma e një provizionit do të jetë vlera aktuale e shumës që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin. Norma e skontimit do të jetë

një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë. Rreziqet specifike të detyrimit duhet të pasqyrohen ose në normën e skontimit ose në vlerësimin e shumave të nevojshme për të shlyer detyrimin, por jo në të dyja.

d) Kur provizioni shlyhet pas 12 muajve pas datës së raportimit, do të njihet me vlerën aktuale të shpenzimeve të pritshme, përveç rastit kur efekti i skontimit është jomaterial.

Enti Kombëtar i Banesave duhet të përjashtojë nga matja e një provizioni fitimet nga nxjerrja e pritshme jashtë përdorimit e aktiveve. Kur disa ose të gjithë shumat e nevojshme për të shlyer një provizion mund të rimbursohen nga një palë tjetër (p.sh. përmes një pretendim sigurimi), Enti Kombëtar i Banesave do ta njohë rimbursimin si një aktiv të veçantë vetëm kur është praktikisht e sigurt se institucioni do ta marrë rimbursimin me shlyerjen e detyrimit.

Shuma e njohur për rimbursimin nuk duhet të kalojë shumën e provizionit. Rimbursimi i arkëtueshëm do të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv dhe nuk do të kompensohet kundrejt provizionit. Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, E.K.B. mund të kompensojë çdo rimbursim nga një palë tjetër kundrejt shpenzimeve në lidhje me provizionin.

2.3. Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve

Enti Kombëtar i Banesave do të rishikojë provizionet në çdo datë të raportimit dhe do t'i rregullojë ato për të pasqyruar vlerësimin më të mirë aktual të shumës që do të kërkohet për të shlyer detyrimin në atë datë të raportimit. Çdo rregullim i shumave të njohura më parë do të njihet në fitim ose humbje me përjashtim kur provizioni është njohur fillimisht si pjesë e kostos së një aktivi.

Kur një provizion matet me vlerën aktuale të shumës që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin, zbritja do të njihet si një kosto financiare në fitim ose humbje në periudhën kur shkaktohet.

Enti Kombëtar i Banesave do të njohë një provizion në bilanc kur:

- ka një detyrim aktual ligjor ose ekonomik si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur para datës së mbylljes së vitit kalendarik,
- ekziston mundësia që për shlyerjen e detyrimit do të nevojitet një dalje e burimeve,
- mund të bëhet një përlllogaritje relativisht e saktë e shumës së detyrimit.


Enti Kombëtar i Banesave do të njohë një provizion në bilancin e saj vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së mbylljes së vitit kalendarik. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të përbëjë një detyrim ligjor ose ekonomik për E.K.B.-në, dhe institucioni nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangjen e këtij detyrimi përveç shlyerjes së tij.

2.4. Përdorimi i provizioneve

Një provizion do të përdoret vetëm për ato lloj shpenzimesh, për të cilat ai është njohur fillimisht. Asnjë shpenzim tjetër, që nuk ka lidhje me provizionin e krijuar, nuk duhet të kompensohet kundrejt tij, pasi kjo do të dëmtonte karakterin objektiv të pasqyrave financiare.

Pasiguria për detyrimet eventuale në krahasim me provizionet është edhe më e madhe. Nëse realizimi i provizioneve është i sigurt dhe shuma mund të çmohet në mënyrë relativisht të besueshme, atëherë realizimi i detyrimeve eventuale është ose i pasigurt ose shuma mund të çmohet me besueshmëri.

Figura e mëposhtme e vendimmarrjes mund të përdoret për të përcaktuar nëse Enti Kombëtar i Banesave duhet të njohë një provizion, të japë shpjegime për një detyrim të mundshëm apo të mos bëjë asnjë veprim.



Në praktikën e sotme ekzistojnë dy tipe provizionesh:

- a) Provizionet për zhvlerësimin
- b) Provizione për risqe e shpenzime

a) Provizionet për zhvlerësimin

Një provizion për zhvlerësim është konstatimi kontabël i një zvogëlimi të vlerës së një elementi të aktivitetit që rezulton nga shkaqe, efektet e të cilave janë gjykuar të pakthyeshme.

Megjithatë karakteri i pakthyeshmërisë, është shpesh i diskutueshëm, provizionet për zhvlerësimin zbatohen përgjithësisht për elementet e paamortizueshme të aktivitetit, por gjithashtu për disa elemente të amortizueshme të aktivitetit që kanë pësuar zhvlerësime të veçanta, por jo të pakthyeshme.

Krijimi i provizioneve për zhvlerësimin

Parimi i krijimit të provizioneve për zhvlerësimin është mjaft i thjeshtë dhe u bindet rregullave të mëposhtme:

- n.q.se në inventar, vlera aktuale e një zëri është më e vogël se vlera e origjinës së regjistruar në bilanc, duhet krijuar një provizion.
- n.q.se në datën e inventarizimit, është konstatuar rasti i kundërt, nuk bëhet asnjë veprim rregullues (parimi i kujdesit).
- n.q.se në datën e inventarizimit të një viti kalendarik të ardhshëm, vlera e negociuar e një elementi që ka qenë tashmë objekt i një provizionit, ka pësuar një modifikim, ka vend për të rregulluar provizionin.

Në këtë rast, është vlera e origjinës që përcakton parimin e llogaritjes së provizionit. Nga ana e Entit Kombëtar të Banesave do të krijohet një provizion për zhvlerësimin, i cili do të mbahet për aq kohë sa të justifikohet, në fund anulohet kur bëhet pa objekt.

- Në bilanc do të njihet një provizion vetëm nëse mundësia për realizimin e tij është më e madhe se 50%, d.m.th. realizimi është më i mundshëm se mosrealizimi.
- Nëse mundësia e realizimit është më e vogël se 50%, provizioni i prituri do të paraqitet nga Specialistët e Financës të Entit Kombëtar të Banesave si një detyrim eventual në shënimet e pasqyrave financiare.

Në përgjithësi është gjithmonë e mundur që të bëhet një çmuarje e besueshme e shumës së një provizionit të nevojshëm, d.m.th. shuma që shoqëron provizionin. Në raste të rralla, kur nuk mund të bëhet një çmuarje e tillë, provizioni nuk do të njihet në bilanc, por faktorët që lidhen me të do të jepen si një detyrim eventual në shënimet e pasqyrave financiare.

Krijimi i një provizionit të ri ose zmadhimi i një provizionit ekzistues normalisht regjistrohet si një shpenzim i vitit kalendarik. Në rastin kur krijimi i një provizionit lidhet me përdorimin ose nxjerrjen jashtë përdorimit të një aktivi, shuma e një provizionit të tillë do të shtohet kostos së këtij aktivi.

Kontabiliteti i provizioneve për zhvlerësimin

Në çdo zë të aktivit të qëndrueshëm të paamortizueshëm dhe të aktivit qarkullues, korrespondon një provizion për zhvlerësimin. Sikurse amortizimet, ky provizion është një element zbritës i zërit përkatës nga zhvlerësimi. Vetëm llogaria e shtetit dhe ajo e thesarit (Arka dhe Banka) nuk mund të jenë objekt i një provizioni.

E rëndësishme është dhe ruajtja e një kodifikimi të veçantë për provizionet për zhvlerësimin. Në fakt, një “9” në rangun e dytë për secilën nga klasat kontabël të aktivit tregon që bëhet fjalë për një provizion për zhvlerësimin e klasës në fjalë.

Shembuj

- 2 - Aktive Afatgjata
- 29 - Provizione për zhvlerësimin e Aktive Afatgjata

- 3 - Inventarët
- 39 - Provizione për zhvlerësimin e inventarëve

- 37 - Inventarët e mallrave
- 397 - Provizione për zhvlerësimin e inventarëve

- 4 - Llogaritë e të tretëve
- 49 - Provizione për zhvlerësimin e kredive

- 41 - Klientë
- 491 - Provizione për zhvlerësimin e llogarive klientë

- 5 - Llogaritë financiare
- 59 - Provizione për zhvlerësimin e llogarive financiare

Kështu, sikurse për amortizimet, fshehja e 9-ës në rangun e dytë lejon të gjendet rrënja e llogarisë së cilës i referohet provizioni.

Këto llogari kreditore funksionojnë në mënyrë analoge me llogaritë e amortizimit. Nga Specialisti i Financës të Entit Kombëtar të Banesave humbja e vlerës nuk do të çohet asnjëherë direkt në kredi të një llogarie aktive, por në kredi të një llogarie provizioni.

Ky lloj kontabilizimi lejon të paraqiten tre informacione themelore në bilancin e Drejtorisë Ekonomike dhe të Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave:

- vlerën e origjinës,
- zhvlerësimet,
- vlerën neto.

b) Provizione për risqe e shpenzime

Prezantimi i aktivitet në bilanc

Shpenzimet e llogaritura janë objekt i një dotacioni global që integron amortizimet dhe provizionet. Kodifikimi i llogarive të provizioneve lejon një shpërndarje të këtyre shpenzimeve në funksion të tre niveleve të analizës në llogarinë e rezultatit.

Vlera bruto	Zhvlerësimi	Vlera Kontabël Neto	Vlera Kontabël Neto (VKN), Viti 201X
1	2	3=1-2	4

Gjithësesi, meqenëse zhvlerësimet mund të reduktohen ose anulohen, është normale që llogari përkatëse kundëparti, me llogaritë e provizioneve, të regjistrojnë këto lëvizje të kundërta. Këto të ardhura të llogaritura të quajtura “rimarrje të provizioneve” adaptojnë egzaktesisht të njëjtin tip kodifikimi. Këto llogari paraqiten në mënyrën e mëposhtme:

Llogaria e rezultatit

	Shpenzime	Të ardhura
Fusha e shfrytëzimit	681 SH.A.P.	781 R.A.P.
Fusha financiare	686 SH.A.P.	786 R.A.P.
Fusha e veçantë	687 SH.A.P.	787 R.A.P.


SH.A.P. = Shpenzim amortizimi dhe provizioni

R.A.P. = Rimarrje amortizimi dhe provizioni

Regjistrimi kontabël

1- Krijimi dhe zmadhimi i provizioneve

Provizionet janë krijuar ose zmadhuar në debi të llogarisë 68 “Shpenzim të amortizimeve dhe provizioneve” në kredi të llogarisë së provizionit përkatës, si vijon:



Shembull 1

Në fund të vitit E.K.B. ka llogaritur provizione për zhvlerësimin e llogarive klientë në shumën 1.000 Lekë. Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
681 4911	SH.A.P. të shfrytëzimit Provizione për zhvlerësimin e llogarive klientë	1.000	1.000

ku SH.A.P. = Shpenzim amortizimi dhe provizioni

2- Zvogëlimi ose anulimi i provizioneve

Në mënyrë egzaktësisht simetrike, provizionet për zhvlerësimin reduktohen ose anulohen në debi të një llogarie provizionesh me kredinë e llogarisë 78 “Rimarrje të amortizimeve dhe provizioneve”, në këtë rast:

29,39,49,59 Llogari të provizioneve për zhvlerësimin		781, 786, 787 R.A.P. = Rimarrje amortizimi dhe provizioni	
Debi	Kredi	Debi	Kredi
X			X



Shembull 2

Në fund të vitit, në vazhdim të një rritjeje të kurseve të bursës, Enti Kombëtar i Banesave duhet të zvogëlojë një provizion për zhvlerësimin e vlerave të lëvizshme të vendosjes me vlerë 5.000 Lekë. Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
590 786	Provizione për zhvlerësimin R.A.P. me karakter financiar	5.000	5.000

ku R.A.P. = Rimarrje amortizimi dhe provizioni

2.5. Provizionet për zhvlerësimin e inventarëve

Përbërja e provizioneve për zhvlerësimin e inventarëve kërkon një njohje të vlerës së tregut të elementeve gjendje në inventar të Entit Kombëtar të Banesave.

Shembull 1

Në datën 31.12.2015, situata e inventarëve të Entit Kombëtar të Banesave është si më poshtë:

- Inventari A, 10.000 Lekë, sipas tregut mund të vlerësohet 12.000 Lekë.
- Inventari B, 40.000 Lekë, sipas tregut nuk i kalon 35.000 Lekë.

Nuk është e nevojshme të konstatohet një provizion mbi inventarin A, pasi vlera e inventarit është më e vogël se vlera e tregut.

Nga ana tjetër, duhet konstatuar një provizion mbi inventarin B, pasi vlera e inventarit është më e madhe se vlera e tregut.

Veprimi kontabël që do të kryhet në këtë rast nga Specialisti i Financës së Entit Kombëtar të Banesave, do të jetë si më poshtë:

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
681 3927	SH.A.P. të shfrytëzimit Provizione për zhvlerësimin e inventarit të imët	5.000	5.000

Pranojmë që gjendja e inventarëve nuk kishte ndryshuar në datën 31.12.2016 dhe që vlerat e tregut janë: a) Inventari A = 9.000 Lekë, b) Inventari B = 39.000 Lekë

Kjo situatë e re do ta çojë Entin Kombëtar të Banesave në krijimin e një provizioni mbi inventarin A (10.000 Lekë – 9.000 Lekë) dhe anulimin pjesërisht të provizionit mbi inventarin B (40.000 Lekë – 39.000 Lekë = 1.000 Lekë të provizionit për t'u krijuar, por ekzistonte tashmë një provizion 5.000 Lekë, që nga një rimarrje 5.000 Lekë – 1.000 Lekë = 4.000 Lekë).

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
681 3927	SH.A.P. të shfrytëzimit Provizione për zhvlerësimin e inventarit të imët	1.000	1.000

Për rimarrjen e provizionit mbi gjendjen e inventarit ekzistojnë dy zgjidhje:

a) Rregullimi aritmetik (5.000 Lekë – 1.000 Lekë = 4.000 Lekë)

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
3927 781	Provizione për zhvlerësimin e inventarit të imët R.A.P. të shfrytëzimit	4.000	4.000

b) Anullimi i provizionit të mëparshëm dhe krijimi i një të riu

Nr. llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
3927 781	Provizione për zhvlerësimin e inventarit të imët R.A.P. të shfrytëzimit	5.000	5.000
681 3927	SH.A.P. të shfrytëzimit Provizione për zhvlerësimin e inventarit të imët	1.000	1.000
	Krijimi i një provizioni të ri		

ku **R.A.P.** = Rimarrje amortizimi dhe provizioni
SH.A.P. = Shpenzim amortizimi dhe provizioni

2.6. Provizionet për klientë të dyshimtë

Provizionet për klientë të dyshimtë të Entit Kombëtar të Banesave, mund të lindin si rrjedhojë e rasteve të mëposhtme:

- a) mos marrëveshjeve midis palëve,
- b) pa aftësisë paguese të klientit, pra mos likuidimit të rregullt të kësteve mujore,
- c) humbjes së besimit, etj.

Këta klientë quhen të dyshimtë sepse arkëtimi nga ana e tyre nuk është i sigurtë. Kjo arsye duhet të çojë Entin Kombëtar të Banesave në krijimin e një provizioni për zhvlerësimin.

Me qëllim që të jenë të zbritshme fiskalisht, ato duhet të plotësojnë një kusht të dyfishtë:

- a- nga njëra anë, klienti të jetë i identifikuar qartësisht,
- b- nga ana tjetër, të bëjnë të mundshëm riskun e mosarkëtimit.

Në këtë rast Dega Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave duhet të evidentojë për klientët e saj, të dhënat si vijon: emrin e klientit, shumën e detyrimit, vjetërsinë e klientit (datën e lidhjes së kontratës) dhe situatën aktuale të klientit.

Procedura kontabël do të jetë si më poshtë:

a) Analiza e klientit

Në fund të vitit kalendarik, nëse klienti paraqet një anomali mosarkëtimi, kalohet në një llogari të veçantë 416 “Klientë të dyshimtë”. Kjo procedurë ndiqet kur egziston një dyshim i vërtetueshëm.

b) Konstatimi i një provizioni

Shuma e provizionit duhet të korrespondojë me humbjen e mundshme që duhet të përballojë Dega Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave.

Shembull 1

Në datën 31.12.201X, Dega Rajonale bën një gjendje të klientëve të saj dhe nxjerr se 400.000 Lekë janë të pa arkëtueshme mbi klientin “X”. Rregjistrimi i parë do të konsistojë në transferimin e shumës së të drejtës së dyshimtë në llogarinë 416 “Klientë të dyshimtë”.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
416 411	Klientë të dyshimtë Klientë	400.000	400.000

Hipoteza 1

Në fund të vitit kalendarik 201X+1 (pra të vitit tjetër), klienti nuk ka paguar ende, dhe duke patur parasysh situatën e tij, ka vend për krijimin e një provizioni në 50% të shumës, psh: $400.000 \times 50\% = 200.000$ Lekë.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. Llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
81 4911	SH.A.P. të shfrytëzimit Provizione për zhvlerësimin e kredive klientë të dyshimtë	200.000	200.000

Meqenëse situata nuk është zgjidhur ende, llogaria e provizioneve duhet të rregjistrojë shumën e humbjes, e cila është ende e mundshme për Degën Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave.

Hipoteza 2

Në fund të vitit kalendarik, në datën 31.12.201X+1 (viti tjetër), klienti i derdh Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave shumën 100.000 Lekë për të mbyllur një pjesë të detyrimit të tij, por nuk do të derdhë më. Pra ai mbetet borxh edhe 300.000 Lekë ndaj Entit Kombëtar të Banesave.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

a) Etapa e parë

Specialisti i Financës i Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave duhet të rregjistrojë derdhjen në bankë të shumës 100.000 Lekë dhe të mbyllë llogarinë e klientit të saj, i cili i detyrohet për 400.000 Lekë, dhe të konstatojë humbjen që i krijohet.

Totali = 400.000 Lekë

Arkëtime = 100.000 Lekë

Borxhi i keq = 400.000 Lekë – 100.000 Lekë = 300.000 Lekë.

Specialisti i Financës i Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave vitin e kaluar, duke qënë se rrezikohej arkëtimi i këtij klienti, ka krijuar provizion në shumën 200.000 Lekë dhe është kontabilizuar si shpenzim në llogarinë 681 “Provizion për shfrytëzim”.

Mbetet për të llogaritur diferenca tjetër:

100.000 Lekë = 400.000 – 200.000 (provizion i krijuar) – 100.000 (arkëtim)

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
512	Banka	100.000	
654	Humbje nga klientë të paarkëtuar	100.000	
4911	Provizion për zhvlerësim	200.000	
416	Klientë të dyshimtë		400.000
	Veprim me arkëtim dhe provizion		

b) Etapa e dytë


Specialisti i Financës i Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave kishte krijuar një provizion për zhvlerësimin, shuma e të cilit do të korrespondojë me humbjen e mundshme, 200.000 Lekë.

Në rastin e zgjidhjes pjesërisht së situatës, Dega Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave ka arkëtuar vetëm 100.000 Lekë. Në këto kushte do të duhet të raportojë vlerën 100.000 Lekë në gjendjen e cash-it dhe për këtë është kryer veprimi kontabël duke debituar llogarinë 512 “Banka” dhe kredituar llogarinë 416 “Klientë të dyshimtë”.

Kështu duke analizuar llogaritë e rezultatit për të dy vitet, në fund të vitit të dytë kalendarik (në datën 31.12.201X+1), konstatohet që:

- humbja e regjistruar në llogarinë 654 “Humbje nga klientë të paarkëtuar” është 100.000 Lekë,
- në vitin e mëparshëm (201X), humbja e regjistruar në llogarinë 681 “Provizione të shfrytëzimit” është 200.000 Lekë,
- gjithsej për të dy periudhat, humbja do të llogaritet si vijon: 200.000 Lekë + 100.000 Lekë = 300.000 Lekë.

Në mënyrë skematike paraqitet si më poshtë:



Në këtë rast, në vitin e parë kemi humbje 200.000 Lekë ndërsa në vitin e dytë, me arkëtim nga klienti prej 1.000.000 Lekë, humbja është 100.000 Lekë, dhe për të dy vitet humbja llogaritet 300.000 Lekë.

Dega Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave mund të imagjinojë të gjitha situatat e ndërmjetme midis mosmbulimit total të një klienti dhe mbulimit të saj të pjesshëm (ose të plotë).

Provizionet janë fonde rezervë që shërbejnë si garanci për të mbuluar kreditë e pashlyera nga klientët. Në bazë të vonesës së pagesës së kësteve të kredisë, në Degët Rajonale të E.K.B.-së klasifikimi i kredive do të bëhet si mëposhtë:

- | | |
|-----------------------------|---------------------|
| • Kredi standarte | 0-30 ditë vonesë |
| • Kredi në ndjekje | 31-90 ditë vonesë |
| • Kredi nënstandarte | 91-180 ditë vonesë |
| • Kredi të dyshimta | 181-365 ditë vonesë |
| • Kredi pa shpresë arkëtimi | mbi 365 ditë vonesë |

Norma për llogaritjen e provizioneve për mbulimin e humbjeve nga kreditë, do të aplikohet si për principalin edhe për interesin. Kjo do të kërkojë një analizë në vazhdimësi nga ana e stafit përkatës

të Degëve Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave dhe mbi bazën e kësaj analize Drejtoria e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues do të konkludojnë normat e provizioneve dhe do të vendoset mënyra më e mirë dhe më e përshtatshme se si duhet të procedohet më tej.

3. NJOHJA E PROVIZIONEVE - FUSHA SPECIFIKE

3.1. Provizionet e garancisë

Enti Kombëtar i Banesave duhet të krijojë provizione të garancisë nëse jep garanci për produktet që shet apo shërbimet që ofron. Ngjarja detyruese në këtë rast është shitja e produktit ose ofrimi i shërbimit. Në rast se Enti Kombëtar i Banesave jep garanci për produktet që shet, në pasqyrat financiare do të njihet një provizion i barabartë me shumën e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të garancisë për produktet e shitura deri në datën e raportimit.

Provizionet, të vlerësuara në mbyllje të llogarive, destinohen të mbulojnë risqet dhe shpenzimet që i bëjnë të mundur ngjarjet e ndodhura ose që priten të ndodhin, të përcaktuara qartë përse i përket objektit, por realizimi i të cilave nuk është i sigurt.

Shembull 1

Në datën 31.12.201X, në mungesë të faturës Enti Kombëtar i Banesave mund të vlerësojë me 4.000.000 Lekë shumën e punëve të kryera nga njësia ekonomike "X".

Kjo shumë 4.000.000 Lekë është një vlerësim i asaj që Enti Kombëtar i Banesave duhet të paguajë për këtë riparim. Shpenzimi është plotësisht i njohur, vetëm pagesa është e mëvonshme, duke u bërë kështu objekt i një detyrimi të provizionuar.

Shembull 2

Në fund të vitit kalendarik, Enti Kombëtar i Banesave konstaton që do t'i duhet të ribëjë çatinë e një ndërtese. Risku egziston, shpenzimi është i mundur por realizimi mund të presë. Kjo situatë e dytë karakterizohet nga një risk i njohur, i përcaktuar, mbarimi i të cilit është megjithatë i pasigurt.

Fusha e zbatimit të provizioneve për risqe e shpenzime është mjaft e gjerë. Enti Kombëtar i Banesave mund të parashikojë riparime, pasojat e një mosmarrëveshje me një klient ose një të punësuar, të konstatojë ndryshime të kurseve të këmbimit, etj.

Pra në të ardhmen mund të profilizohen detyrimet e mundshme, shpenzimet e ardhshme, origjina e të cilave është mjaft e njohur dhe mungesa e marrjes në konsideratë të së cilave, do të ishte e paragjyqeshme për sinjeritetin e bilancit.

Në të kundërt, marrja parasysh në njohjen e tyre të një pjese të detyrimeve apo riskut të ardhshëm, i lejon Entit Kombëtar të Banesave një kursim të brendshëm, që do të jetë me natyrë mbulimin e financimit të tij në të ardhmen.

Kështu, ky sistem i paraprirjes dhe shpërndarjes së shpenzimeve të ardhshme zbatohet:

- për risqet e shfrytëzimit (mosmarrëveshje me klientët);
- për risqet financiare (ndryshimet e **kurseve të këmbimit**);
- për risqet e veçanta (gjyba, dëmshpërblime, etj).

Enti Kombëtar i Banesave do të monitorojë lëvizjet e kurseve të këmbimit dhe do të menaxhojë pozicionet e saj në valutë të huaj, në bazë të **Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit”**.

Rreziku i ndryshimeve të kurseve të këmbimit specifikon rrezikun e ndikimeve në rezultatet financiare dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të shkaktuar nga ndryshimet në kurset e këmbimit.

Enti Kombëtar i Banesave ka një nivel të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të ndryshimeve të kurseve të këmbimit pasi nuk hyn në pozicione të hapura valutore, dhe nuk angazhohet në transaksione që rrjedhin prej tyre.

Transaksionet në monedhë të huaj do të rregjistrohen dhe konvertohen në monedhën LEK sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Në fund të vitit do të konvertohen me kursin e këmbimit në datën e bilancit, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Diferencat nga konvertimi do të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të Entit Kombëtar të Banesave.

3.1.1 Kontabiliteti i provizioneve për risqe e shpenzime

Nga Specialistët e Financës në Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, provizionet për risqe e shpenzime do të krijohen kur të njihet risku, do të rregullohen në fund të çdo viti kalendarik, dhe në fund do të rimerren, e thënë ndryshe anulohen, kur të ndodhë risku apo shpenzimi.


Në ndryshim nga provizionet për zhvlerësimin që vijnë në zvogëlim të aktivitetit, provizionet për risqe e shpenzime zmadhojnë pasivin e bilancit.

Megjithatë, mekanizmi kontabël është i njëjti. Në fakt, në funksion të nivelit të tij në llogarinë e rezultatit, shpenzimi konstatohet në formën e një amortizimi dhe provizioni me karakter:

- **shfrytëzimi (681)**
- **financiar (686)**
- **të veçantë (687)**


me kredinë e një llogarie të provizioneve për risqe e shpenzime.

Nga kjo rrjedh skema e mëposhtme:



3.1.2. Zvogëlimi ose anulimi i një provizioni

Llogaritë 781, 786, 787, regjistrojnë në kredinë e tyre zvogëlimet e provizioneve (Rimarrjet e provizioneve), duke debituar llogarinë 15 “Provizione për risqe e shpenzime”. Në këtë rast, skema do të jetë si mëposhtë:



ku R.A.P. = Rimarrje amortizimi dhe provizioni
 SH.A.P. = Shpenzim amortizimi dhe provizioni

Shembull 1

Në datën 31.12.201X, Enti Kombëtar i Banesave duhet të rregjistrojë një provizion për riskun lidhur me një grindje me një klient të pakënaqur. Risku është vlerësuar në vlerën 800.000 Lekë.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
687 151	SH.A.P. me karakter të veçantë Provizione për risqe e shpenzime	800.000	800.000

Në datën 31.12.201X+1 (pra vitin tjetër), grindja nuk është rregulluar ende, dhe është vendosur që provizioni të llogaritet 1.000.000 Lekë. Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
687 151	SH.A.P. me karakter të veçantë Provizione për risqe e shpenzime	1.000.000	1.000.000

Gjatë vitit 201X+2, gjykata dënon Entin Kombëtar të Banesave t'i derdhë një dëmshpërblim prej 150.000 Lekë klientit të saj. Zgjidhja e situatës është bërë, në këtë rast Specialisti i Financës i Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave do të kontabilizojë dëmshpërblimin e pagueshëm dhe të rimarrë provizionin.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:


Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
67 512	Shpenzime të veçanta Banka	150.000	150.000

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
151 787	Provizione për risqe e shpenzime R.A.P. me karakter të veçantë	1.000.000	1.000.000

Prezantimi i llogarive të rezultatit për tre vitet, lejon të shpërndahet shpenzimi prej 150.000 Lekë, i cili ka qenë i ndarë në disa pjesë:

- 80.000 Lekë për vitin 201X,
- 20.000 Lekë për vitin 201X+1,
- së fundi 50.000 Lekë për vitin 201X+2.

Nga kjo rrjedh skema e mëposhtme:



3.2. Provizionet që lidhen me çështjet gjyqësore

Provizioni për çështjet gjyqësore do të njihet nga Enti Kombëtar i Banesave kur ndodh ngjarja detyruese që çon në çështje gjyqësore, kur ka mundësi që do të paguajë shpenzime lidhur me këtë çështje gjyqësore dhe kur shuma përkatëse mund të llogaritet me besueshmëri.

Enti Kombëtar i Banesave do të njohë një provizion në pasqyrat financiare të tij, në lidhje me të gjitha çështjet gjyqësore ekzistuese dhe ato të mundshme, në rastet kur:

- Një ngjarje detyruese, që ka krijuar çështjen gjyqësore, ka ndodhur para datës së raportimit.
- Është e mundshme që Enti Kombëtar i Banesave të përballojë shpenzime, në lidhje me zgjidhjen e çështjes gjyqësore.
- Shuma e shpenzimeve të pritshme, që lidhen me çështjen gjyqësore, mund të vlerësohet relativisht me saktësi.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura, provizioni nuk do të njihet në datën e raportimit, por çështjet që lidhen me gjyqin do të përshkruhen si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të Entit Kombëtar të Banesave.

Ndonëse shpesh mund të bëhet vetëm një vlerësim i përafërt i shumës që ka të bëjë me çështjet gjyqësore, kjo nuk përbën arsye për moskrijimin e një provizioni. Vetëm në raste të rralla, kur shumat që lidhen me çështjet gjyqësore mund të jenë shuma të ndryshme për skenarë të ndryshëm, dhe probabiliteti i këtyre skenarëve nuk mund të parashikohet me besueshmëri, provizioni nuk do të njihet, por një përshkrim i çështjeve gjyqësore do të paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Shembull

Në ngarkim të E.K.B.-së është trajtuar një çështje gjyqësore. Proçedura e gjyqit është në vazhdim me datën e mbylljes së bilancit. Juristët e E.K.B.-së çmojnë se shpenzimet që lidhen me çështjen gjyqësore mund të jenë 200.000 Lekë dhe 300.000 Lekë për mundësinë e humbjes së gjyqit. Në këtë rast Specialisti i Financës i Entit Kombëtar të Banesave njih një provizion në shumën 250.000 Lekë, pra 50% të shpenzimeve të mundshme.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. llog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
681 15	Shpenzime për rreziqe Provizione për rreziqe	250.000	250.000
	Për çështjen gjyqësore		

3.4. Provizionet që lidhen me kontratat me kushte rënduese

Kontrata me kushte rënduese është një kontratë, në të cilën kostot e pashmangshme të përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës i tejkalojnë përfitimet ekonomike që priten të merren në bazë të saj.

Një provizion për kontratat me kushte rënduese do të kontabilizohet me shumën më të vogël midis humbjes që lidhet me përmbushjen e kontratës (d.m.th. të ardhurat nga kontrata minus koston që lidhet me përmbushjen e saj) ose gjobës për pezullimin e kontratës.

Kostot e pashmangshme në bazë të kontratës pasqyrojnë koston neto më të ulët për të dalë nga kontrata, që është më e ulëta midis koston së përmbushjes së kontratës dhe çdo kompensimi ose gjobe që rrjedh nga mospërmbushja e saj.

3.5. Provizionet për detyrimet mjedisore

Në pasqyrat financiare të saj, Enti Kombëtar i Banesave do të krijojë një provizion për detyrimet mjedisore që kanë lindur para datës së raportimit nëse:

- Sipas legjislacionit, kërkohet likuidimi ose kompensimi për një dëm specifik,
- Enti Kombëtar i Banesave ka treguar nëpërmjet veprimtarive dhe politikave të tij mjedisore, se ai synon ta likuideojë vullnetarisht dëmin mjedisor.

Për detyrimin mjedisor do të njihet një provizion i barabartë me shumën e kostove që lidhen me likuidimin e dëmit, përfshirë këtu edhe gjobat e mundshme. Nëse Enti Kombëtar i Banesave preferon të paguajë gjobat në vend të likuidimit të dëmit, do të njihet një provizion i barabartë me shumën e gjobave të mundshme.

Nëse detyrimi mjedisor ka ndodhur si rezultat i blerjes, krijimit ose përdorimit të një aktivi, atëherë shuma e provizionit do të përfshihet në koston e aktivit. Kur detyrimi mjedisor rezulton në një shtesë të çmimit të blerjes së aktivit, Enti Kombëtar i Banesave duhet të analizojë nëse kjo tregon se vlera e re kontabël e aktivit mund të mos jetë plotësisht e rikuperueshme.

Për këtë, Enti Kombëtar i Banesave duhet të kryejë testin e zhvlerësimit të aktivit, duke vlerësuar shumën e tij të rikuperueshme dhe në përputhje me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, duhet të kontabilizojë humbjen nga zhvlerësimi.

Enti Kombëtar i Banesave duhet të njohë një provizion për detyrime mjedisore kur ai ka një detyrim ligjor ose një detyrim konstruktiv për të likuiduar apo kompensuar një dëm të caktuar ndaj mjedisit. Provizioni duhet të llogaritet si shuma aktuale e çdo pagese në të ardhmen, përfshirë gjobat e mundshme.

Shembull

Enti Kombëtar i Banesave është duke ndërtuar një banesë, gjatë gërmimit ka dëmtuar ambientin përreth dhe Inspektoriat i Mjedisit e ka gjobitur me 100.000 Lekë. Gjobën ende nuk e ka paguar, mbasi ka kundërshtime dhe ka filluar procedurat ankimore.

Marrim rastin sikur pretendimet e institucionit për këtë gjobë nuk janë argumentuese dhe të gjitha rrethanat tregojnë që Enti Kombëtar i Banesave do ta paguajë gjobën. Në këto kushte E.K.B. krijon provizionin në shumën 100.000 Lekë.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. Ilog	Emërtimi i Ilogarive	Debi	Kredi
681 15	Shpenzime për provizione Provizione për rreziqe	100.000	100.000
	Për gjobat e mjedisit		

3.5. Provizionet për kostot e ristrukturimit

Ristrukturimi është një riorganizim i veprimtarisë së Entit Kombëtar të Banesave, në bazë të një plani të veçantë veprimi, të zbatuar nga drejtuesit e insitucionit, si rezultat i të cilit fusha e veprimit të biznesit të ndërmarrë, ose mënyra se si kryhet ky biznes, do të ndryshojë në mënyrë të

konsiderueshme. Pra do të ndryshojë organizimi dhe drejtimi, me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë ekonomike. Shembuj të ristrukturimit janë mbyllja ose zhvendosja e njësive të caktuara të rëndësishme, ndryshime të konsiderueshme në strukturën e drejtimit që çojnë në shkurtimin e disa prej anëtarëve të stafit drejtues e të tjera të ngjashme.

Kur një detyrim konstruktiv ka lindur si pasojë e një programi ristrukturimi, Enti Kombëtar i Banesave do të njohë në bilancin e saj një provizion, vetëm nëse para datës së raportimit (datës së mbylljes së bilancit):

1.- Ka hartuar një plan të detajuar zyrtar për ristrukturimin, duke identifikuar të paktën:

- (a) biznesin ose pjesën e një biznesi në fjalë,
- (b) vendet kryesore që ndikohen,
- (c) vendndodhjen, funksionin dhe numrin e përafërt të punonjësve të cilët do të kompensohen për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës,
- (d) shpenzimet që do të ndërmerren,
- (e) kohën kur do të zbatohet plani.

2.- Ka krijuar një pritshmëri të vlefshme tek palët përkatëse se Enti Kombëtar i Banesave do të kryejë ristrukturimin (pra ka paraqitur çështjet kryesore të programit të ristrukturimit) duke filluar me zbatimin e planit ose duke njoftuar karakteristikat e tij kryesore atyre që ndikohen prej tij (duke krijuar besim tek palët përkatëse për zbatimin e këtij programi).

Një provizion ristrukturimi do të përmbajë vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta që ndodhin vetëm njëherë, si rezultat i zbatimit të programit të ristrukturimit, dhe që nuk janë të lidhura me veprimtaritë e Entit Kombëtar të Banesave pas ristrukturimit.

Shembuj të shpenzimeve të ristrukturimit, që diktojnë krijimin e një provizioni, janë:

- a) shpenzimet që lidhen me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës,
- b) shpenzimet që lidhen me mbylljen e një njësie,
- c) shpenzimet që lidhen me kontratat që janë shndërruar në kontrata me kushte rënduese, si rezultat i ristrukturimit (p.sh. marrëveshjet e qirasë financiare që kthehen në kontrata me kushte rënduese pas ristrukturimit).

Për shpenzimet e mëposhtme nuk do të krijohet provizion ristrukturimi, pasi ato nuk janë të lidhura me vetë ristrukturimin, por janë të lidhura me veprimtaritë e institucionit pas ristrukturimit:

- a) shpenzimet për rikualifikimin e punonjësve dhe ripozicionimin e tyre,
- b) shpenzimet e marketingut,
- c) shpenzimet që lidhen me zhvillimin e sistemeve të reja.

Shembull 1

Marrim rastin sikur Drejtimi i Entit Kombëtar të Banesave është në procesin e mbylljes së aktivitetit pasi nuk ka ecuri të mirë. Drejtimi ka bërë një shpallje publike për ristrukturimin e

njësisë dhe ka filluar të zbatojë planin e ristrukturimit. Drejtimi ka përlogaritur një sërë shpenzimesh, por është akoma në diskutim se cilat nga këto shpenzime do të çojnë në krijimin e një provizionit.

Shembull 2

Enti Kombëtar i Banesave që është në ristrukturim e sipër, për punonjësit e shkurtuar parashikon të shpenzojë për paga dhe shpenzime 500.000 Lekë. Ristrukturimi filloi në datën 20.12.201X, dhe për këtë do të krijohet një provizion.

Regjistrimi kontabël që kryhet në këtë rast, është si më poshtë:

Nr. Ilog	Emërtimi i llogarive	Debi	Kredi
681 15	Shpenzime për provizione Provizione për rreziqe	500.000	500.000
	Për ristrukturimin e njësisë		

4. DETYRIMET E KUSHTËZUARA

Detyrim i kushtëzuar është një detyrim që:

a) mund të krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose disa ngjarjeve të ardhshme të pasigurta, që nuk janë nën kontrollin e plotë të Entit Kombëtar të Banesave,

b) ose një detyrim ekzistues, krijuar nga ngjarje të shkuara, por që nuk kontabilizohet pasi nuk është e mundur që shlyerja e këtij detyrimi të shoqërohet me një dalje të burimeve,

c) ose shuma e detyrimit nuk mund të vlerësohet relativisht me saktësi.

Shembuj të detyrimeve të kushtëzuara janë:

a) një detyrim që lidhet me proceset gjyqësore të nisura ndaj Entit Kombëtar të Banesave, të cilat institucioni nuk parashikon t'i humbasë,

b) një kredi e marrë nga një njësi tjetër dhe e garantuar nga Enti Kombëtar i Banesave, garanci që nuk pritet të shkaktojë shpenzime për insitucionin, pasi është në gjendje t'i shlyejë detyrimet.

Detyrimet e kushtëzuara nuk do të njihen, përveç provizioneve për detyrimet e kushtëzuara të një njësie të blerë në një kombinim biznesi, por në lidhje me to do të jepet informacion në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Detyrimet e kushtëzuara, realizimi i të cilave është shumë pak i mundshëm, nuk kanë nevojë të paraqiten në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

5. AKTIVET E KUSHTËZUARA

Një aktiv i kushtëzuar është një kërkesë e mundshme që lind nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të institucionit. Shembull i një kërkesë të mundshme është një ankesë që Enti Kombëtar i Banesave i ka paraqitur një njësie tjetër, realizimi i së cilës varet nga rezultati i proceseve gjyqësore.

Enti Kombëtar i Banesave nuk do të njohë një aktiv të kushtëzuar si një aktiv dhe duhet të japë informacion shpjegues për një aktiv të kushtëzuar, në rastet kur është e mundshme një hyrje e përfitimeve ekonomike.

Megjithatë, kur fluksi hyrës i përfitimeve të ardhshme ekonomike të Entit Kombëtar të Banesave është pothuajse i sigurtë, atëherë aktivi nuk është një aktiv i kushtëzuar dhe është e mundur njohja e tij.

6. PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS

Provizionet do të paraqiten duke përdorur zërat përkatës në formatin e pasqyrës së pozicionit financiar të dhënë në **Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare”**.

Provizionet, që priten të realizohen brenda 12 muajve pas datës së mbylljes së raportimit, p.sh. provizionet e krijuara në lidhje me proceset gjyqësore, do të regjistrohen nga Enti Kombëtar i Banesave në zërin “Provizione afatshkurtra”.

Shpenzimet që lidhen me krijimin e provizioneve do të regjistrohen në atë zë të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, me të cilin kanë më shumë lidhje. Reduktimi i provizioneve do të regjistrohet tek i njëjti zë i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, ku janë njohur më parë shpenzimet, në lidhje me krijimin e provizionit.